

**William R. Hite, Jr., Ed.D.**  
Superintendent

9 Dhjetor, 2021

Të nderuar prindër dhe familje të Drejtorise Arsimore të Filadelfias

Drejtoria Arsimore e Filadelfias është e përkushtuar të ofrojë mjedise të sigurta dhe gjithëpërfshirëse të të mësuarit që mbështesin shëndetin emocional dhe mendor të të gjithë nxënësve tanë, siç përshkruhet në [Objektivat e Bordit të Edukimit](#). Si pjesë e këtij angazhimi, ne jemi të entuziazuar t'ju njoftojmë se duke filluar nga dita e Hëne, 13 Dhjetor 2021, **studentët do të kenë mundësinë të zgjedhin një opsion gjinor jo-binar (jo vetëm 2)** përveç opsioneve mashkullore dhe femërore që do të shfaqen në “Infiniti Campus” (student dhe portalet familjare), google classroom ose të dyja.

[Rregullorja 252 e Drejtorisë](#) pohon të drejtën e studentëve transgjinorë dhe jokonform gjinor për të zgjedhur dhe identifikuar si emrin dhe gjininë e tyre të preferuar, edhe kur kjo është e ndryshme nga ajo që është e shtypur në certifikatën e tyre të lindjes. Në mbështetje të kësaj rregulloreje, studentët mund të komunikojnë preferencën e tyre për mënyrën se si emri dhe gjinia e tyre shfaqen te Zyra e të Drejtave dhe Përgjegjësive të Studentëve duke përdorur formularin e lidhur [këtu](#), pa ofruar dokumentacion ligjor ose pa pasur nevojë për miratimin e prindit ose kujdestarit. Ata kanë dy opsione:

- 1) **Përditëso emrin dhe/ose gjininë vetëm në Google:** Kjo do të shfaqet vetëm në Google si Google Classroom, Google Meet, etj.
- 2) **Përditëso emrin dhe/ose gjininë në SIS (që përfshin Google):** Përveç Google, informacioni i përditësuar shfaqet në  **shumicën e sistemeve të tjera që përballen me studentët dhe shkollat**, të tilla si Schoolnet, vlerësimet STAR, dëftesa e notave, etj.

Është e rëndësishme të theksohet se këto përditësime nuk do të shfaqen në asnjë sistem shtetëror dhe në asnjë mënyrë nuk zëvendësojnë një emër ligjor të studentit. Kur dorëzon informacion në Departamentin e Arsimit të Shtetit të PA-së, Drejtoria do të jetë në gjendje të vërejë se një student identifikohet si jobinar, por shtetit i kërkon të regjistrojë dhe shfaqë informacionin nga certifikata ligjore e lindjes. Ne vazhdojmë të avokojmë që ndryshime të ngjashme të miratohen në nivel shtetëror dhe federal.

Nëse keni pyetje shtesë, ju lutemi vizitoni [www.philasd.org/studentrights/lgbtqia/](http://www.philasd.org/studentrights/lgbtqia/) ose kontaktoni [policy252@philasd.org](mailto:policy252@philasd.org).

Ky është një hap i rëndësishëm përpara në përpjekjen tonë për t'u bërë një drejtori arsimore sa më e drejtë dhe më gjithëpërfshirëse. Faleminderit për partneritetin tuaj ndërsa ne përpiqemi të mbështesim mirëqënien fizike, mendore dhe emocionale të të gjithë fëmijëve të Filadelfias.

Sinqerisht

A handwritten signature in cursive script that reads "William R. Hite Jr.".

William R. Hite Jr., Ed.D.  
Superintendent  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias